

AKTI I THEMELIMIT TE SHOQERISE

“DO-AL” SHPK

Ne baze te ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”; vendosem hartimin e ketij statuti

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1:

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, më date 30.03.2018 ortaket Robert Rrotani , i lindur Barbullush me dt 20.01.1966 dhe banues ne Rranxa, me ID G60120130E leshuar nga ministria e mbrendeshme, vendosem per krijimin e shoqerise “DO-AL” SHPK me kushtete e me poshteme.

Neni 2:

Objekti

Objekti i veprimtarise se shoqeris“DO-AL” SHPK, do te jete, Tregti me pakice dhe shumice karburant- lubrifikant si dhe import- eksport.

Neni 3:

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat.

Neni 4:

Selia

Selia qendrore e shoqerise do te jete: **Bushat , Rruga Nacionale Bushat – Shkoder, zona kadastrale 1329, ndertese me nr pasurie 347/12/108, godine 1 kateshe.**

Neni 5

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 Lekë . Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1.Ortaku themelues Robert Rrotani: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100.000 që përben 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajshme/të paluajshme apo të drejta)

Neni 6

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.



Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
 - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 7 **Administrimi**

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, nga 30.03.2018 deri në 30.03.2023 me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Administratori shoqërisë do të jetë Robert Rrotani, I datlindjes 20.01.1966, me nr ID G60120130E

ORTAKET **E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR** **“DO-AL” SHPK**

ROBERT RROTANI

